



MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
DREJTORIA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE
SEKTORI I ZBATIMIT TË POLITIKAVE, PROJEKTEVE DHE STRATEGJIVE

Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
Viti 2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	27.01.2025	Kërkesë për informacion mbi dosjen e shtetasit A. K	27.01.2025	Në vijim të e-mailit tuaj, një e-mail sqarues mbi situatën e z. A. K i është dërguar Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë. Me e-mailin e datës 21.01.2025, specialist/juriste e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë ka kthyer përgjigje, si më poshtë vijon: <i>“Përshëndetje ! Duke uruar të jeni mirë! Z. A. K është paraqitur pranë Qshnjp Korçë në datën 13.03.2023, me kërkesë për ndihmë juridike dytësore, kategori e veçantë përfitues i skemës sociale, për çështjen me objekt vërtetimi i atësisë për fëmijën lindur jashtë martese. Ka përfituar ndihmë</i>	E plotë	Nuk ka

			<i>juridike dytësore, si proces i është zgjatur për arsye se gjyqtarja e parë që kishte çështjen u largua, gjyqtari i dytë nuk e kaloi vettingun. Pasi u zbardh vendimi çështja i ka kaluar avokate E.H, e cila i ka përgatitur edhe kërkesë padinë për në gjykatë. Në çështjen e Z. A. K ka një problem të tillë përpara se t'i drejtohej Ndhmës Juridike, i është drejtuar Tlas në vitin 2022, duke qenë se nuk mori përgjigje vazhdoi procedurën në Qshnjp Korçë. Aktualisht çështja e tij po trajtohet edhe nga Tlas edhe nga avokatja e listes tonë.</i> Gjithashtu, referuar protokollit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, konstatohet se z. A. K i është drejtuar Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me kërkesën Nr.18 Prot, datë 06.01.2025, ku bashkëlidhur është kërkesë-padia drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e përgatitur nga avokate E.H, avokate e listës së ndihmës juridike. Në këto kushte procedura përse i përket marrjes së çështjes nga avokati i listës së ndihmës juridike falas është ezauruar dhe avokate E.H e ka dorëzuar Kërkesë-padinë, me paditës A. K, i paditur J.R, person i tretë J.Sh, me objekt Vërtetim njohje atësie, kundërshtimin e atësisë së prezumuar, detyrimin e gjendjes civile të regjistrojë vajzën me atësi dhe mbiemër paditësin A. K dhe rivendojse në afat për ngritjen e padisë, protokolluar nga gjykata në datën 30.12.2024. Mbi situatën e dosjes së z. A. K në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk kemi më tepër informacion. Sa më sipër, lutem Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë t'i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për t'u informuar mbi situatën e dosjes së z. A. K, duke kërkuar një përsheptim të gjykimit të çështjes, për arsye që ndikojnë në arsimimin e fëmijës së mitur. Ju informoj se kërkesë-padia ka datën e	
--	--	--	--	--

				depozitimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, 30.12.2024.		
2	03.02.2025	Kërkesë për informacion mbi ndikimin e pezullimit të financimeve nga SHBA.	04.02.2025	Në vijimësi të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nuk merr financime apo fonde nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.	E plotë	Nuk ka
3	07.03.2025	Kërkesë për informacion për likujdim pagese për shtetasin P.D.	13.03.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për sa i përket dosjes së përfituesit P. D, ju informojmë që: Pas administrimit të dosjes kemi konstatuar që dosja nuk është e plotë dhe me shkresat nr.83/4 prot., datë 06.03.2025 i jemi drejtuar Dhomës Vendore të Avokatisë Elbasan për të na percjellë vendimin e caktimit tuaj si avokate për përfituesin P.D (në kopje origjinale ose të njehsuar) dhe me shkresën nr 83/5, datë 6.03.2025 i jemi drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për percjelljen e vendimit nr.1328 (13.2024-5338) datë 20.11.2024 me paditës P. D (në kopje origjinale ose të njehsuar) . Pas plotësimit të dosjes do vijohet me vlerësimin e shërbimit të dhënë ndaj përfituesit të ndihmës juridike z. P.D në përputhje me Urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019, i Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.	E plotë	Nuk ka

4	22.03.2025	Vënie në dijeni për ankimin e depozituar nga shtetasi P.D pasi ka kërkuar të përfitojë ndihmë juridike dytësore sipas vendimi të object padisë sipas vendimit nr. 1320 dt. 20.11.2024.	01.04.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj për çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse: paditës K.R, e paditur A. K dhe objekt kundërshtim i atësisë së prezumuar, keni përcjellë vetëm kopje të vendimit nr.1103, datë 25.09.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me palë dhe objekt si më lart cituar. Me qëllim që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të vijojë me vlerësimin e shërbimit juridik që avokatja ka ofruar për këtë çështje, nevojitet plotësimi i dokumentacionit të duhur ligjor si vijon: · Formulari për shpërblimin për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore, vendosur si kriter për shpërblim për shërbimin e ofruar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 05.08.2020 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”, (nënshkruar nga ju); · Aneksi 2- Skeda e Klientit miratuar me Urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”, i nënshkruar nga ana juaj; · Raporti për përfundimin e punës për ofrimin e ndihmës juridike dytësore sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, vendosur si kriter për shpërblim për shërbimin e ofruar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 05.08.2020 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”, (nënshkruar nga ju);	E plotë	Nuk ka
---	------------	--	------------	--	---------	--------

				· Vendimi i gjykatës përkatëse që ka vendosur pranim të kërkesës për ndihmës juridike dytësore falas, vendosur si kriter për shpërblim për shërbimin e ofruar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 05.08.2020 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”, (origjinal ose i njësuar me origjinalin); · Vendimi nr.1103, datë 25.09.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me palë dhe objekt si më lart cituar (origjinal ose i njësuar me origjinalin); · Aktet ligjore të hartuara nga ana juaj dhe të depozituara në gjykatë në funksion të gjykimit të kësaj çështje, vendosur si kriter për shpërblim për shërbimin e ofruar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 05.08.2020 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”.		
5	02.05.2025	Informacion mbi mbylljen e dosjes së shtetasit P. D dhe nëse kanë kaluar pagesat përkatëse. Informacion nëse është marrë dokumentacioni	09.05.2025	Ne vijim te kerkesave per informacion te avokates S.S ju informojme qe: • <i>Me shkresën nr.38/9 dt 25.04.205 avokatja është njoftuar mbi arsyet e mospagesës për shërbimin e ofruar ndaj përfituesit P. D.</i> • <i>Persa i përket pyetjes së dytë të avokates fatura lëshohet pas përfundimit të shërbimit dhe përcillet pranë DNJF së bashku me dokumentacionin e plotë.</i> • <i>Në lidhje me dosjen e përfituesit I. Ç, ju informojmë se nga verifikimi në protokoll ende</i>	E plotë	Nuk ka

		përfundimtar për shtetasin I. Ç.		nuk kemi një kthim përgjigje nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan sipas shkresës nr.38/7 prot., datë 9.04.2025 dhe as nga ana e avokates sipas shkresës nr.38/8 prot., datë 9.04.2025. Sjellim në vëmendje se për çështjet e përfunduara avokatja duhet të dorëzoj pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas disa dokumenta të nevojshëm për vlerësimin e shërbimit të ofruar në mënyrë që të vijohet me shlyerjen e detyrimit konkretisht: 1. Raport për përfundimin e punës – Relacion; 2. Aktet e hartuara nga Avokati të cilat vërtetojnë ndjekjen e çështjes dhe hapat që janë ndërmarrë në funksion të saj; 3. Formulari për shpërblimin (publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas); 4. Aneksi 2 -Skeda e klientit të ndihmës juridike dytësore (miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 531, datë 25.11.2019); 5. Vendimi i Gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridikes; 6. Vendimi i Dhomës Vendore të Avokatisë për caktimin e avokatit që do të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike dytësore; Vendmi përfundimtar i Gjykatës lidhur me çështjen për të cilën është kërkuar ndihmë juridike; Në përfundim të shërbimit të kryer duhet të lëshohet fatura elektronike në përputhje me parashikimet e Udhëzimit rr.18, datë 95.08.2620, “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”. <u>Theksojmë edhe një herë pas përfundimit të shërbimit d.m.th pasi është mbyllur çështja dorëzohet dokumentacioni i plotë pranë Drejtorisë së ndihmës</u>	
--	--	----------------------------------	--	---	--

				<u><i>Juridike Falas dhe merret në vlerësim dosja nga ana jonë.</i></u>		
--	--	--	--	---	--	--

Përditësimi i fundit i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve: **04.06.2025**

Koordinatori për të Drejtën e Informimit
Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
Helga Çela